



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 21.4.2015, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu, Murat Hoxha, Lahi Brahimaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 1.4.2015,
3. Shqyrtimi i propozim rekomandimeve të grupit punues rreth çështjes së cilësisë së grurit të importuar,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1.4.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi i propozim rekomandimeve të grupit punues rreth çështjes së cilësisë së grurit të importuar

Kryetari përshëndeti anëtarët e komisionit dhe hartuesit të rekomandimeve fillimisht ja dha fjalën. **Adem Salihaj** ritheksoi të dhënat e cekura në dokumentin e dorëzuar me shkrim duke

propozuar në fund rekomandimet e harmonizuara në GP, të cilat prapë mund të plotësohen, nëse ka vërejtje konkrete, rekomandimet janë si vijon :

1. Qeveria të ndërmarrë veprimet e duhura të përgjegjësisë ndaj stafit udhëheqës të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës së Kosovës, e cila, siç u pa nga raporti, ka dështuar në tërësi që ta kryejë punën dhe detyrat e përcaktuara me ligj. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës e Kosovës, përmes një riorganizimi, të shndërrohet në institucion të përgjegjshëm dhe të aftë që ta kryejë me sukses punën e tij, në mënyrë që popullata e Kosovës të jetë e mbrojtur nga produktet ushqimore të cilësisë së dyshimtë dhe të dëmshme për organizmin.
2. Rekomandohet që të evitohet evazioni fiskal nga gruri i importuar, si dhe prodhimet nga gruri i importuar. Nga Qeveria të përcaktohen kuota të importit të grurit, me qëllim që të mos importohet më shumë se sa janë nevojat reale të popullatës së Kosovës. Në anën tjetër, të lejohen sasitë e nevojshme për eksport, por ato të kontrollohen rigorozisht, në mënyrë që të përdoren për këtë destinim e të mos plasohen në tregun e brendshëm. Këto masa duhet të merren me qëllim që të mbrohet dhe stimulohet prodhimi vendor i grurit.
3. Qeveria të ketë një mbikëqyrje më serioze ndaj Doganave të Kosovës, në aspektin e kontrollit të cilësisë së grurit nga importi, si dhe në aspektin e zbatimit të ligjit dhe Kodit Doganor lidhur me taksat doganore për importuesit e grurit.
4. Të ndërmerren masa kontrolli dhe përgjegjësie ndaj përgjegjësve të Institutit Bujqëor të Kosovës në Pejë, për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë dhe atij profesional. Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim me Këshillin e Akreditimit, të ndërmarrë veprimet e duhura për akreditimin e këtij instituti.
5. Të kërkohet nga Administrata Tatimore e Kosovës një kontroll më i madh në çështjet e evazionit fiskal të importueseve të grurit në Kosovë.
6. Tre muaj pas aprovimit të këtij Raporti me Rekomandime, Qeveria t'i raportojë Kuvendit të Kosovës lidhur me hapat dhe veprimet e ndërmarra.

Salih Salihu kryesues i GP konfirmoi se rekomandimet janë propozuar bashkërisht mirëpo propozoi edhe disa plotësime sidomos në rekomandimin 2 ku duhet të ceket se kuota në kuadër të politikave fiskale duhet të favorizoj prodhimin vendor të grurit. **Shaip Muja** tha se nuk mundet kjo çështje e kuotës të imponohet tregtarëve, ngase janë taksat mbi një nivel të caktuar, kryesore është, vazhdoi, në rekomandime të ceket a kemi siguri dhe cilësi, dhe të rekomandohet qartë që Qeveria dhe ministria e bujqësisë nuk kanë treguar përgjegjësinë e duhur në këtë rast si plotik bërës ndërsa AUV si ekzekutues i kësaj politike. Ai gjithashtu u pajtua me raport rekomandime por jo edhe me disa analiza detale (p.sh. zyreve, kompjuterëve etj), gjithashtu nuk duhet të ceket fjala riorganizim në rekomandimin e parë. **Murat Hoxha** tha se nuk prish punë me mbet, ngase për riorganizim duhet të epet pëlqimi prej Qeverisë. **Lahi Brahima** tha se raporti nuk ka nevojë të miret me shumë gjëra të panevojshme gjithashtu vërehet që AUV më parë ka qenë nën ombrellën e MB kurse pastaj është ndarë nga ajo duke shkuar pranë ZKM, pse kjo lëvizje, mirë është të shkruhet përcaktimi i sa tonëve mund të hyj, pastaj duhet të ceket që Qeveria nuk duhet të ndëshkoi fermerët e vegjël, pse me urdhërin e kryeministrit ka shku AUV me marr mostrën dhe nuk ka pasur përgjigje, nuk mundet të caktohet çmimi nëse nuk ka paraprakisht para (nuk jepen subvencionet) etj. **Murat Hoxha** potencoi se në fillim GP përkatësisht komisioni nuk ka pasur mjaft indikator, ndërsa tani falënderoi për këtë raportim duke sugjeruar që në rekomandimin 1 duhet me nda a bëhet fjalë për menaxhment apo menaxher, ndërsa rekomandimit të dytë mund ti hiqet pjesa e dytë. **Haxhi Shala** ishte i mendimit që të potencohet në rekomandime se Qeveria mbanë përgjegjësinë kryesore për ushqimin në Kosovë, në çka ka dështua. **Adem Salihaj** u pajtua dhe shtoi se rekomandimet mund të pësojnë ndryshime, megjithëse vërtetoi se rezultati i rekomandimeve të propozuara është përgjegjësia e Qeverisë dhe dëmtimi i cilësisë së grurit. **Emilija Redzeqi** konfirmoi pajtimin e sajë me vërejtjet e parashtruara dhe njoftoi komisionin me takimet e saja me përfaqësuesit e ambasadës së

Holandës (agjencia e ushqimit) dhe Norvegjisë (pyjet) të cilët kanë premtuar mbështetje për bujqësinë tonë, ndaj në marrëveshje me stafin dhe kryetarin e komisionit do të vizitohen këto dy ambasada.

Kryetari përmbylli mbledhjen duke njoftuar për njoftimin me shkrim që në ZRRUK është caktuar ushtruesi i detyrës **Ramiz Krasniqi** dhe caktoi për javën e ardhshme :

- Vizita në dy ambasada të hënën ose të martën sipas koordinimit të deputetes E. Redzepi dhe stafit me kryetarin,
- Të dërgohen vërejtjet e anëtarëve të komisionit deri të premtën rreth grurit,
- Mbledhja e komisionit të mbahet më 29 prill duke ftuar ministrin e MMPH sipas agjendës më parë të caktuar, dhe të vendos komisioni për rekomandime pas shkuarjes së ministrit

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka